



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 4

Rrogozhinë, më 27.04.2023 ora 14 : 00^{oo}

Zhvillohet mbledhja e shtyrë e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Kjo mbledhje konsiderohet e shtyrë pasi ishte thirrur të zhvillohej me datë 26.04.2023.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.1579.Prot datë 20.04.2023 si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.3, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 27.03.2023.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2023 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2023 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Raport nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe sektori i Shërbimeve Publike mbi masat e marra për përmisimin e shërbimeve ndaj qytetarit dhe përgatitjen e sezonit turistik.
- 6- Raporti i detajuar mbi veprimtarinë e zyrës së punës në Bashkinë Rrogozhinë.
- 7- Të ndryshme.
 - *Kërkesë për ndihmë financiare për mbulimin e shpenzimeve për arsye shëndetësore.*

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Petrit Haska, Vojsava Pipa, Reshit Kala, Anjeza Proshka, Sheqere Biba, Fatmira Thartori, Lulzim Hasa, Alime Hoxha, Alban Sula, Margarita Dedej, Mukades Gixhari.

Mungojnë :

Erind Tosku, Enver Memolla, Haqim Tosku, Avni Kasa, Agim Pepa, Luan Sheshi, Fatjon Biba, Mejte Saliu, Emiliano Aliu.

Të ftuar :



1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
3. Olsi Dranga - Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse.
4. Ledian Hasani - Përgjegjës i Shërbimit Social.
5. Ramazan Sula - Përgjegjës i zyrës së punës Rrogozhinë.
6. Mario Meka - Përgjegjës i zyrës IT.
7. Sidorela Troka - Specialiste Juriste.

Drejtton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm gjithsej 11 Këshilltarë.

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Përshëndetje të nderuar Këshilltarë! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur!

Marrin pjesë në mbledhje këshilltarët : z. Petrit Haska, znj. Vojsava Pipa, Reshit Kala, znj. Anjeza Proshka, znj. Sheqere Biba, znj. Fatmira Thartori, z. Lulzim Hasa, znj. Alime Hoxha, z. Alban Sula, znj. Margarita Dedej dhe Mukades Gixhari. Gjithsej jemi 11 Këshilltarë.

Kalojmë në leximin e “Verifikimit Ligjor” ardhur nga Prefekti i Qarkut Tiranë për vendimet e Këshillit Bashkiak të datës 27.03.2023.

Këshillit Bashkiak Rrogozhinë, bazuar në ligjin Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8 gërma a, neni 16, gërma 2/a dhe Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Prefekti i Qarkut Tiranë verifikoi ligjshmërinë e vendimeve nr.3,4,5,6,7 datë 27.02.2023 të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë.

Vendimi nr.8, datë 27.03.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% “ është në përputhje me ligjin.

Vendimi nr.9, datë 27.03.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2023 nga fondi i pushtetit vendor” është në përputhje me ligjin.



Vendim nr .10, datë 27.03.2023 “Për një ndryshim të Vendimit Nr.15, datë 02.03.2000 të Këshillit Bashkiak për emrin e shkollës 9-vjeçare “Xhorxh Soros“. Konfirmohet referuar ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Vendim nr .11, datë 27.03.2023 “Për miratimin në parim të servitutit të kalimit të një sipërfaqe bujqësore e ndodhur në Rrogozhinë fshat, parcela 35/4,35/5,35/13, ZK 3450 dhe parcelat 272/1 dhe 274/1, ZK 3235 Bashkia Rrogozhinë”. Nuk është në përputhje me nenin 4 të ligjit nr.77/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.133/2015 dhe kthimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.

Vendim nr .12, datë 27.03.2023 “Për mbylljen dhe disiplinimin e varrezës të fshatit Zeshtik Njësia Administrative Kryevidh” konfirmohet në parim referuar ligjit nr.9220, datë 15.04.2004 “Për administrimin e shërbimit të varrimit publik” i ndryshuar për zbatimin e tij zbatohen paraprakisht nenet 12 dhe 13 të ligjit nr.9220, datë 15.04.2004 “Për administrimin e shërbimit të varrimit publik” i ndryshuar, si dhe nenin 22 të VKM-së nr.711, datë 29.10.2014 “Për miratimin e rregullores për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin Prefekti, Afrim Qendro.

Mukades Gixhari . Të nderuar këshilltarë, para se të kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës do të gjeni të fotokopjuar përpara secili kopje të projektvendimit, “Për disa ndryshime në vendimin nr.6, datë 27.01.2020 për krijimin e komisionit për programet e strehimit social (dhënien e subvencionimit të qirasë për shkak të fatkeqësive natyrore, subvencionimin e kredisë me interesa të ulët, si dhe për dhënien e banesave sociale me qira)“, **të projektvendimit** “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin ‘Subvencionimi i initeresave të kredisë’ “,Të dy këto projektvendime u shtyn nga mbledhja e kaluar në këtë mbledhje për shkak të mungesës së relatorit të cilin sot e kemi prezentë.

Jeni dakord t’i përfshijmë në rendin e ditës këto 2 projektvendime dhe i shqyrtojmë në pikën “Të ndryshme” ? E hedhim në votim. Të gjithë pro vota ime shkon pro. Miratohet.

-Miratohet me 11 vota pro përfshirja në rendin e ditës e projektvendimit me nr.1090.Prot datë 17.03.2023, “Për disa ndryshime në vendimin nr.6, datë 27.01.2020 për krijimin e komisionit për programet e strehimit social (dhënien e subvencionimit të qirasë për shkak të fatkeqësive natyrore, subvencionimin e kredisë me interesa të ulët, si dhe për dhënien e banesave sociale me qira)“, dhe të projektvendimit me shkresë Nr.1091.Prot datë 17.03.2023 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin ‘Subvencionimi i initeresave të kredisë’ “,Të dy këto projektvendime u shtyn nga mbledhja e kaluar në këtë mbledhje për shkak të mungesës së relatorit të cilin sot e kemi prezentë.



Mukades Gixhari . Miratimi i rendit të ditës. E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro pika 1 (një) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën e dytë, Miratimi i procesverbalit nr.3, të mbledhjes së këshillit bashkiak datë 27.03.2023. E hedhim në votim. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro pika 2 (dy) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Miratimi i projektvendimit për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2023 nga fondi i bllok – ndihmës 6%. Përgjegjësi i Shërbimit Social z. Ledian Hasani. Përshëndetje Ledian, fjala për ju!

Ledian Hasani . Gjithsej janë 22 familje përfituese sipas listës dhe fondi është 92 mijë lekë të reja.

Mukades Gixhari . Letrat i keni përpara. Ka ndonjë pyetje? E hedhim në votim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro pika 3 (tre) e rendit të ditës.

Vendim nr .13. Miratohet me 11 vota pro projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.1515.Prot datë 13.04.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2023 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6% “.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 4, “Miratimi i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2023 nga fondi i pushtetit vendor”. Vazhdojmë po me përgjegjësin e shërbimit social z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Janë 18 familje përfituese dhe fondi është 65 mijë lekë të reja. Ndonjë pyetje? E hedhim në votim. Pro, kundra, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

- Miratohet me 11 vota pro pika 4 (katër) e rendit të ditës.

Vendim nr .14. Miratohet me 11 vota pro projektvendimi i ardhur nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.1583.Prot datë 20.04.2023, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2023 nga fondi i pushtetit vendor“.



Mukades Gixhari . Faleminderit Ledian. Kalojmë në pikën 5 (pesë), raport nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe sektori i Shërbimeve Publike mbi masat e marra për përmisimin e shërbimeve ndaj qytetarit dhe përgatitjen e sezonit turistik. Drejtori i shërbimeve mbështetëse z. Olsi Dranga. Zotëria i pikës6-të është këtu? Atëherë jeni dakord ta kalojmë pikën 5? Në rregull pika 6, Raporti i detajuar mbi veprimtarinë e zyrës së punës në Bashkinë Rrogozhinë. Përgjegjësi i zyrës së punës z. Ramazan Sula. Përshëndetje!

Ramazan Sula . Përshëndetje të gjithëve! Atëherë në zyrën e punës Rrogozhinë rezultojnë të regjistruar 1000 punëkërkuar të papunë nga të cilët 600 persona janë me status pezull. Në statusin pezull përfshihen të gjithë punëkërkuar të papunë të cilët nuk janë të gatshëm për të punuar për arsye të ndryshme si largësia e vendbanimit, mungesa e çerdheve, kopshteve, përkujdesja ndaj fëmijëve të mitur, ndaj personave të tjerë në familje të paaftë etj. Nga të dhënat që ne disponojmë në sistemin informatik të shërbimeve të punësimit në zyrën e punës Rrogozhinë janë 793 punëkërkuar të papunë të cilët janë përfitues të ndihmës ekonomike. Për të patur një informacion më të saktë për numrin e personave përfitues me ndihmë ekonomike jeni të lutur t'i drejtoheni Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë. Punëkërkuar të regjistruar kryesisht janë nga zonat rurale, kanë arsim të ulët dhe si rrjedhojë janë pa profesion. Punët në të cilët këta persona mund të përshtaten janë pozicione elementare si psh punëtor krahu, punonjës pastrimi etj. Vendet e lira të punës aktualisht janë fasoneri, fabrika, ku mund të orientohen një pjesë e punëkërkuarëve.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje? Faleminderit Ramazan. Rikethehemi tek pika 5, Raport nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe sektori i Shërbimeve Publike mbi masat e marra për përmisimin e shërbimeve ndaj qytetarit dhe përgatitjen e sezonit turistik. Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse z. Olsi Dranga. Përshëndetje Olsi, fjala për ju.

Olsi Dranga . Përshëndetje të gjithëve! Këtë raport e kemi përgatitur në çdo vit përpara sezonit turistik për shërbimet dhe për hir të vërtetës këtë vit është viti i parë që ne do kemi përmirësim të shërbimit sepse në mbështetje edhe të ministrisë së turizmit Agjencisë Kombëtare të Bregdetit do të kemi mundësi që në zonën bregdetare të rrisim shërbimin e pastrimit. Bëhet fjalë për Vilë Bashtovën dhe Spillenë do ketë shtim të koshave, do ketë shtim të makinerive të cilat bëjnë pastrimin dhe orari do jetë i mbuluar dhe i ndarë në dy kohë, një pjesë e kohës do jetë pastrim i realizuar nga firma “Viola Green” një pjesë e kohës tjetër do jetë e organizuar nga kompania e cila është kontraktuar nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit. Normalisht problematika të ndryshme kemi në zonë për të cilat jemi në dijeni kemi dhe një plan masash për të dhënë disa zgjidhje emergjente dhe pastaj nuk e di nëse ka ndonjë rast emergjence nga anëtarët e këshillit për ta diskutuar në lidhje me raportin apo shërbimet që do jepen. Psh në Luz të Madh kemi qenë



në takim para 2-3 ditësh është një problematikë tek varrezat dhe atë jemi duke e zgjidhur për ujin. Jemi duke e zgjidhur sot ka shkuar personi edhe po përgatit me bazë materiale, ju referova rastit sepse kështu e gjetëm rast pas rasti në varësi pastaj të problematikës.

Petrit Haska . Kryetare diçka kisha. Jemi dakord, po koshat problematikë ka qenë dhe është.

Olsi Dranga . Ne në Njësinë Administrative Lekaj kemi plotësuar 15 kosha të rinj, përpara 1 muaj e gjysëm 2 muaj. Administratori pastaj do të jetë ai që do të bëjë shpërndarjen, i ka marrë në dorëzim dhe i ka dërguar në vendet ku ka qenë më e nevojshme, tani nuk e di rastin konkret ta flas dhe me Altinin.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje tjetër për drejtorin e shërbimeve mbështetëse.

Alime Hoxha . Të zgjidhet ky problem në të gjithë vijën bregdetare Spille deri në Vilë Bashtovë është problem pjesa e pastrimit.

Olsi Dranga . Atëherë për këtë sezon jemi shumë të qetë për shkak të kontratës dhe për kompaninë e cila do të jetë në ndihmë vetëm për pjesën e sezonit turistik do jemi të qetë për këtë vit që flasim vitin e kaluar nuk kemi qenë në këto kushte.

Fatmira Thartori . Të them diçka, atëherë përmendët dy firma .

Olsi Dranga . Po, “Viola Green” e cila bën pastrimin në territorin e Bashkisë dhe një kompani tjetër e cila është kontraktuar nga AKB.

Fatmira Thartori . Këto fonde që do merren për firmën e dytë janë nga Bashkia, janë parashikuar në planin afatmesëm, apo në buxhetin e ...?

Olsi Dranga . Këto janë fonde që vijnë nga buxheti i Ministrisë .

Fatmira Thartori . Ok, në rregull thashë se preken fondet tona. Shpresojmë që të jetë ambient i pastër i kulturuar sikurse e meritojmë ne, gjithë qytetarët e Rrogozhinës.

Reshit Kala . Unë jo më larg se dje më ka rastisur që të kaloj në Spille dhe e vura re një gjë që ndoshta ato që jetojnë atje e shohin më shpesh, prerja e pishave. Në disa vende vjet ishte shumë e dendur, sivjet sikur janë rralluar a kemi ndonjë kontroll që mos lejohet më prerja se është gjynah? Apo është pronë private dhe ai mund të bëjë çfarë të dojë?



Olsi Dranga . Askush nuk mund të prekë asnjë pishë, ta ketë me pronë private ta ketë me dokument me çdo gjë nuk mund të prekë asnjë degë pishë pa një dokument.

Fatmira Thartori . A kontrollohen, a monitorohen dhe a ka kush monitorim për këtë pjesë?

Olsi Dranga . Realisht administratori duhet të jetë në vëmendje të plotë për këtë ngjarje bashkë me IMTV-në për rastin konkret, administratori që është...

Fatmira Thartori . A monitorohen dhe kush është grupi i monitorimit? Mund të bëjmë një raport për këtë pjesë?

Olsi Dranga . Bëhet fjalë për të njëjtën zonë që ka qenë problematikë e dy tre viteve të fundit për të njëjtën hapësirë?

Reshit Kala . Se kam idenë kush ka qenë problematikë?

Olsi Dranga . Afër kanalit ngjitur me kanalin midis “Perlës” dhe “Bibës” ?

Reshit Kala . Po ajo zonë aty.

Lulzim Hasa . Ai është pyll i vitit 97 një njeri që shkon rrallë nuk e kupton unë jam përditë aty asnjë dru nuk pritet. Ai Banushi është një tokë që e ka blerë.

Alban Sula . Ajo ashtu ka qenë të paktën unë e mbaj mend 20 vjet.

Lulzim Hasa . Bie në sy sikur e ka prerë, ai po bën një gjë të bukur me lulishte.

Fatmira Thartori . Është pronë private por pema nuk prehet, është e mbrojtur.

Lulzim Hasa . Është e ruajtur nuk mund të gjesh pyll më të bukur se të Spillesë .

Reshit Kala . Prandaj e bëra këtë pyetje.

Lulzim Hasa . Ai ka qenë pjesë e zhveshur edhe para se ta merrte ai. Është e thyer bllokun rrugën do hiqet ajo.

Fatmira Thartori . Do bëhet ndërtesa.



Lulzim Hasa . Ku bëhet ndërtesë aty.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje tjetër? Atëherë të falenderojmë shumë Olsi për informacionin që na dhatë.

Olsi Dranga . Faleminderit dhe ju.

Mukades Gixhari . Kalojmë tek të ndryshmet. Kërkesë për ndihmë financiare për mbulimin e shpenzimeve për arsye shëndetësore.

Lulzim Hasa . Kryetare kam unë diçka. Në mbledhjen e muajit Mars na është paraqitur një kërkesë për një banor të fshatit Zhabjak Lulzim Xihani. Ku u shqyrtua në Këshill dhe Këshilli ra dakord që t'i jepnim një ndihmë të menjëhershme ku për vlerën e ndihmës u pyet Rezarti ramë dakord për 30 mijë lekë. Dhe në këtë mbledhje u ftua Rezarti të sillte projektvendimin për këtë person. Nuk shoh projektvendim këtu edhe si mund të bëj unë tani vendim për këtë personin tjetër, nxirr protokollin Lulzim Xihani. U ngarkua Rezarti, administrata të sillte një projektvendim me 30 mijë lekë të reja, kështu ramë dakord, projektvendim nuk ka.

Rezart Vogli . Kemi edhe një rast tjetër që bëhet fjalë znj. Haxhire Lusha dmth dy raste projektvendimi ka qenë gati por për arsye se duke pasur parasysh edhe veprimet financiare para zgjedhjeve . Faktikisht unë e kisha parashikuar herën e kaluar nuk është se e përcaktuam 30 mijë lekë unë e kam përgatitur për 50 mijë lekë .

Mukades Gixhari . Është përgatitur projektvendimi por nuk është firmosur për arsye objektive.

Lulzim Hasa . Unë jam i detyruar si Këshilltar i asaj zone të pyes.

Rezart Vogli . Projektvendimi është përgatitur për masën e shpërblimit 50 mijë lekë po duke qenë se jemi përpara zgjedhjeve të jemi pak të kujdesshëm me veprimet financiare që do bëjmë është gati projektvendimi.

Mukades Gixhari . Po do rikthehem tek projektvendimi që keni përpara “Për disa ndryshime në vendimin nr.6, datë 27.01.2020 për krijimin e komisionit për programet e strehimit social (dhënien e subvencionimit të qirasë për shkak të fatkeqësive natyrore, subvencionimin e kredisë me interesa të ulët, si dhe për dhënien e banesave sociale me qira)”.

Rezart Vogli . Është projektvendim për disa ndryshime për përbërjen e komisionit duke qenë se



Bashkia e Rrogozhinës ka pasur ndryshime të stafit dhe është bërë zëvendësimi i tyre. Komisioni merret me dosjet që dorëzohen nga aplikantët për banesat sociale për kreditë e buta që aplikohen nëpërmjet bankave të nivelit të dytë. Kërkohet ndryshimi në përbërjen e komisionit.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje rreth këtij projektvendimi?

Rezart Vogli . Rastet e personave apo familjeve që aplikojnë për kredinë e butë kanë një formular sistem pikëzimi, komisioni është i përbërë nga punonjës të bashkisë nga koordinatorë dhe përfaqësues të komunitetit, është kryetari i të paftëve i cili nuk ka lidhje me Bashkinë i përmbahet kriterëve ligjore sipas udhëzimit të ardhur nga Ministria dhe kemi bërë përgatitjen e komisionit duke u bazuar...

Anjeza Proshka . Sa kuota ishin?

Rezart Vogli . 7 anëtarë. Këtu nuk ka lidhje me kuotat.

Fatmira Thartori . A ka numër të kufizuar për këtë që duhet të jetë një cak të aplikojë për këtë apo kush të dojë nga këto familje që përmbush kriteret janë të lirë të aplikojnë?

Anjeza Proshka . E di që ka qenë me kuota.

Mario Meka . Mund të ndërhyj zyshja? Çdo njeri ka të drejtë të aplikojë pastaj në qoftë se ...

Mukades Gixhari . Atëherë jemi të qartë në lidhje me këtë projektvendim? E hedhim në votim? Kush është pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11 vota pro projektvendimi me Nr.1090.Prot datë 17.03.2023, Për disa ndryshime në vendimin nr.6, datë 27.01.2020 për krijimin e komisionit për programet e strehimit social (dhënien e subvencionimit të qirasë për shkak të fatkeqësive natyrore, subvencionimin e kredisë me interesa të ulët, si dhe për dhënien e banesave sociale me qira)”.

Vendim nr.15. Miratohet me 11-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.1091.Prot datë 17.03.2023, “Për disa ndryshime në vendimin nr.6, datë 27.01.2020 për krijimin e komisionit për programet e strehimit social (dhënien e subvencionimit të qirasë për shkak të fatkeqësive natyrore, subvencionimin e kredisë me interesa të ulët, si dhe për dhënien e banesave sociale me qira)“.

Mukades Gixhari . Dhe projektvendimi tjetër është, “Për miratimin e sistemit te pikëzimit për



programin ‘Subvencionimi i initeresave të kredisë’ “. Të dy këto projektvendime u shtyn nga mbledhja e kaluar.

Rezart Vogli . Janë përcaktuar dhe në udhëzimin e Ministrisë së Financave nga drejtoria përkatëse kështu që është procedurë.

Mukades Gixhari . Po, Reshiti.

Reshit Kala . Jo, ta votojmë jam pro.

Mukades Gixhari . Atëherë keni ndonjë gjë për të diskutuar? E hedhim në votim. Kush është pro kundër abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro projektvendimi me Nr.1091.Prot datë 17.03.2023 “Për miratimin e sistemit te pikëzimit për programin ‘Subvencionimi i initeresave të kredisë’ “.

Vendim nr.16. Miratohet me 11-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.1091.Prot datë 17.03.2023 “Për miratimin e sistemit te pikëzimit për programin ‘Subvencionimi i initeresave të kredisë’ “.

Fatmira Thartori . A mund të bëj një pyetje? Po për këto të strehimit. Në qoftë se një familje dëshiron të marrë kredi, a ka cak sa mund të jetë shuma që do të marri? Pra në qoftë se plotëson kriteret.

Rezart Vogli . Atëherë ka punë me bankën është banka e nivelit të dytë ajo që vazhdon procedura më tej, bashkia nuk ka pjesë.

Fatmira Thartori . Faleminderit.

Anjeza Proshka . Bëhen dhe përlllogaritje sa i ke të ardhurat vjetore, sa anëtarë je në familje.

Mukades Gixhari . E falenderojmë Rezartin. Tek të ndryshmet nëse keni gjë, atëherë ju falenderoj të gjithëve. Mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur.

-Këshilltarët përshëndesin njëri tjetrin.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 14 : 30^{oo} . (Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati në total 28 min ; 01 sek).

- Ky procesverbal mbyllet në faqen (njëmbëdhjetë).

Miratohet procesverbali :

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :

Sekretari i Këshillit

Ervis Shera